



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më
24.11.2014, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së dhe Cuneyd Ustaibo, shef i subjektit politik KDTP-së.

Munguan: Ylli Hoxha, shef i GP të LVV-së, dhe Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, përfaqësuesi i INPO-së dhe përfaqësuesi i OSBE-së,

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;
2. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2015;
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronave komunale;
4. Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror;
5. Propozimrregullorja për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme;
6. Diskutim për cilësinë e arsimit në komunën e Prishtinës;
7. Propozimrregullorja e punës e gjimnazit “Sami Frashëri”;
8. Të ndryshme.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, kryesuesi **Halim Halimi**, tha se **Propozimrregullorja e punës e gjimnazit "Sami Frashëri"** është e papërpunuar mirë, dhe kjo rregullore është dashur të miratohej në Këshillin e shkollës. Duhet të bëhet një rregullore e punës për të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës (rregullore e përgjithshme) dhe t'i ndajnë shkolla në të përgjithshme dhe profesionale. Sa i përket pikës së gjashtë të rendit të ditës – Diskutim për cilësinë e arsimit në komunën e Prishtinës, ai propozoi që të shtyhet për mbledhjen e radhës, në mënyrë që të diskutohet për cilësinë e arsimit pas përfundimit të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor.

Sami Hamiti theksoi se Propozimrregullorja e punës e gjimnazit "Sami Frashëri" nuk është e përgatitur për Kuvend, andaj propozoj që të hiqet nga rendi i ditës. Duhet të hartohet një rregullore unike ose vetëm për gjimnaze, ose vetëm për shkolla profesionale.

Agim Salihu dha sqarime lidhur me këto dy pika.

Dardan Sejdiu përkrahu heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës për këtë mbledhje të Kuvendit dhe propozoi që të përgatitet materiali, ndërsa për cilësinë e arsimit në komunën Prishtinës sugjeroi që të diskutohet tani, në vija të trasha, për shkak të procesit të punës së Kuvendit të Komunës.

Hatixhe Hoxha shprehu mendimin se çështja e cilësisë së arsimit në komunën e Prishtinës, duhet të kalojë së pari në Komitetin e Arsimit, pastaj të debatohet në Kuvend.

Lirak Çelaj përkrahu shtyrjen e kësaj pike për mbledhjen e dhjetorit.

Kryesuesi konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa u pajtuan që pika e 6 e rendit të ditës, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, me sugjerimin që Komiteti i Arsimit dhe Drejtoria e Arsimit ta sjellin materialin të përgatitur.

Po ashtu, u shty edhe pika e 7-të e rendit të ditës.

Lirak Çelaj tha se janë dy tema për të cilat duhet të diskutohet. Njëra ka të bëjë me një urdhëresë që nuk po zbatohet, se taksa administrative në fuqi për dhënien e lejeve të ndërtimit, është e paligjshme, dhe për një shkresë që ka ardhur nga lagjja "Sofalia" me ankesa, si petition nga qytetarët.

Agim Salihu, sa i përket çështjes së taksave, tha se me këtë merret Drejtoria e Urbanizmit e jo Kuvendi, ndërsa sa i përket petitionit të banorëve të lagjes "Sofalia", ata vërejtjet e tyre mund t'i paraqesin në diskutim publik.

Sami Hamiti theksoi se çështja e petitionit të banorëve të lagjes "Sofalia" duhet të trajtohet, ndërsa për taksat, Drejtoria e Urbanizmit duhet ta bëjë kërkesën në bazë të Udhëzimit administrativë, ta bëjë të ligjshëm taksën për lëshimin e lejeve të ndërtimit.

Dardan Sejdiu kërkoi që taksat t'i trajtojnë në Kuvendin e Komunës, në pikën - Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2015, Agim Salihu dha sqarime.

Halim Halimi propozoi që të mbetet vendimi që ka qenë i grupi punues dhe Agim Salihu t'i bashkëngjitet grupit punues, si dhe një anëtarë i ri i propozuar nga Kryetari, që është z. Osman Bllaca.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2015, me propozimet e dhëna, dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

Pika e tretë

Lidhur me **Propozimvendimin për këmbimin e pronave komunale**, kryesuesi tha se ky këtu kemi të bëjmë me propozimin e Kryetarit për këto dy këmbime të pronave.

Visar Berisha sqaroi se janë dy propozime për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale në Zonën kadastrale Çagllavicë dhe Zonën kadastrale Matiçan.

Sami Hamiti e mbështeti propozimin si pikë, por problemin e shihte pse janë vetëm dy këmbime të pronave, e të mos ketë më shumë këmbime, andaj kjo pikë të dërgohet në Kuvend, mirëpo të bëhet një listë, ku do të paraqitet vazhdimi i mëtejshëm i këmbimit të pronës.

Visar Berisha theksoi se do të ketë edhe raste të tjera të këmbimeve, ndoshta në çdo mbledhje të Kuvendit do të kemi raste për këmbimin e pronës.

Hatixhe Hoxha përkrahu propozimvendimin për këmbimin e pronave komunale.

Lirak Çelaj mbështeti propozimvendimin, por kërkoi që këmbimet të bëhen në një formë më të mirë (të jetë një simetri më e mirë).

Imer Rusinovci u shpreh i pajtimit që të vazhdojë më tutje ky propozimvendim, por duhet shikuar se a janë të barabarta pronat që do të këmben dhe a është bërë klasifikimi i tokës.

Cuneyd Ustaibo përkrahu propozimvendimin për këmbimin e pronave komunale.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronave komunale dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

Pika e katërt

Dardan Sejdiu dha sqarime rreth Informatës për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror, duke cekur optimizmin e tij për projektin e kogjenerimit, që do ta mundësojë ngrohjen me avull për qytetarët e Prishtinës, e që pritet të startojë më 27 nëntor.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Informata për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimrregulloren për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dha sqarime **Agim Salihu**.

Dardan Sejdiu kërkoi që të analizohen edhe një herë pikat 4 dhe 5 të nenit 5.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

Të ndryshme

Kryesuesi, lidhur me kërkesën e Sindikatës për ndihmë punëtorëve për festat e fundvitit, kërkoi që këtë çështje ta ketë parasysh ekzekutivi, ndërsa për kërkesën e shoqatës "Hendikos" për një lokal, mbetet që ekzekutivi të hulumtojë një vend të mundshëm.

Dardan Sejdiu informoi për takimin që kanë pasur me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë, lidhur me formimin e ndërmarrjes "Prishtina Parking" dhe me një këshilltar ligjor të sekretariatit, pra një ekip tre anëtarësh, Kryetari, nënkryetari dhe shefi i Zyrës ligjore, ku është konstatuar se vendimin që e kemi sjellë ne, nuk është në kundërshtim me ligjin. Këtu ishte vetëm një problem, dhe ai problem përfundoi në teknikën e shkrimit. Nesër do të dërgohet raporti mbi qëndrueshmërinë financiare dhe operativën, së bashku me Statutin, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Agim Salihu dha sqarime lidhur me kërkesën e shoqatës "Hendikos".

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtës :
Zijadin Gashi
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur.i dipl.